

VENDIMI

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, e përbërë nga

GJYQTARE : FATIME DEÇOLLI

Sot ne Tirane,me dt.03.05.2017,asistuar nga sekretare gjyqësore **Blerina ORUÇI**, mori në shqyrtim kërkesën që i përket :

KERKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga **prokurorja Antoneta Sevdari**.

OBJEKTI: Vendosje sekuestro preventive.

KUNDER: **S. N.**i biri i **B.** dhe **S.a.**,me dtl.04.09.19..,lindur ne Elbasan,i martuar,me arsim te mesem,i pa denuar me pare,me shtetesi e kombesi shqiptare.

I DYSHUAR: Per vepren penale: Krijimit te skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar , Falsifikimit të formularëve dhe Pastrimit të produkteve të veprës penale të parashikuar nga nenet nga neni 144/a, 190/3 dhe 287 të Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 224,274 i K.Pr.Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën ne seance gjyqësore.Degjoi prokurorEn qe perfundimisht kerkoi nga gjykata pranimin e kerkeses se paraqitur sipas objektit;

V Ë R E N:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka rregjistruar proçedimin penal nr.9749/2014, dhe në përfundim të hetimeve të kryera ka ngritur akuzat në ngarkim të të pandehuri **S. N.**si dhe shoqërive “**E... T... C...**” dhe “ **E... T...E... T... M...**”, per kryerjen e vepres penale të ”Krijimit te skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar” , ”Falsifikimit të formularëve” dhe ”Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar përkatësisht nga nenet nga neni 144/a ,190/3 dhe 287 të Kodit Penal.

Në përfundim të veprimeve hetimore të kryera ka rezultuar se:

Shoqëria ”**E...-06**” sh.p.k, me nipt **K7...8Q**, me administrator shtetasin nën hetim **M. D.**është shoqëri tregtare me objekt të veprimtarisë së saj: ”Zhvillimi i i aktivitetit minerar dhe

tregtimit të materialit të ndërtimit”, me zyrë qendrore (seli) Kamëz Bathore, banesë private 1 katëshe, por me vend të ushtrimit të aktivitetit Fshati ..., Pranë kësaj shoqërie është ushtruar kontroll Tatimor nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë gjate vitit 2014. Inspektori i kontrollit tatimor ka kërkuar të evidentoj gjëndjen fizike të disa mallrave, të cilat janë deklaruar si të blera gjatë vitit 2014 nga shoqëria ” E...-06”. Administratori i shoqërisë pasi është njohur me faturat e deklaruar si blerje nga shoqëria e tij ka deklaruar se mallrat e pasqyrura, në këto fatura tatimore nuk janë blerë nga shoqëria që ai administron dhe si rrjedhojë mallrat e përshkruara në këto fatura nuk janë gjëndje fizike.

Mbi bazen e konstatimeve të gjetuara në subjekt është përfunduar raport kontrolli për subjektin juridik “E... 06” sh.p.k, nga i cili kanë rezultuar detyrime tatimore në shumën prej 50,703,613 lek (përfshirë këtu gjoba dhe interesa), të cilat janë pasqyruar në Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore me Nr. ... Prot, datë 08.12.2014.

Referuar faturave të blerjes të shoqërisë “ E... 06” sh.p.k, në periudhën tatimore Maj- Gusht të vitit 2013 janë kryer blerje të shumta nga subjekte të ndryshëm tregtarë, blerje të cilat nuk i kanë shërbyer aktivitetit të kësaj shoqërie. Administratori i shoqërisë i pandehuri M. D.ka deklaruar në mënyrë permanente se këto mallra nuk janë blerë asnjëherë nga shoqëria. Ai ka pretenduar gjate hetimit se faturat tatimore të blerjes për peirudhen në fjale, janë deklaruar nga zyra e kontabilitetit të tij pa dijeninë e tij.

Po ashtu, rezulton se për afërsisht në të njëjtën periudhë kohore, subjekti E... 06 ka lëshuar dhe deklaruar në tatimeve 6 fatura shitje në vlerën totale përfshirë TVSh 123,160,878 lek, për shoqëritë “E... T... C...” sh.p.k dhe “ E... T...E... T... M...” .

Nga kqyrja e ekstraktit të Raiffeisen Bank të subjektit “E... 06”, rezulton se ky subjekt ka pasur pagesa pjesore për këto fatura dhe menjëherë këto kreditime kanë kaluar kryesisht për pagesën e rentës minerare. Këto pagesa janë bërë nga subjektet “E... T... C...” dhe “ E... T...E... T... M...”, me qëllim që të paguaj renta minerare, nga ana e subjektit shitës “E... 06”, kusht ky që duhet të plotësohet për zhblokimin e mallit në doganë, me qëllim eksportimin e tij. Veprimet kryesisht në bankë, për llogari të subjektit “E... 06” i ka kryer i pandehuri R. D., aksioner i subjektit dhe njëkohësisht vëllai i administratorit.

Pas kryerjes së kontrollit tatimor, dhe nxjerrjes së detyrimeve në vlera të larta për shoqërinë, administrator i shoqërisë “E... 06”, i pandehuri M. D., ka paditur shoqëritë “E... T... C...” dhe “ E... T...E... T... M...”, me objekt padie: “Detyrimin e pales se paditur “E... - S... - T... - C... “SH.P.K te paguaje cmimin per shitjen e mallit ne vleren 43.740.000 leke. Detyrimin e pales se paditur E... T...E... T... M... GROUP SH.P.K te paguaje cmimin per mallin e shitur ne vleren 41.227.290 leke. Detyrimi objekt padie rridhte nga faturat e shitjes të lëshuara nga subjekti „E... 06“ sh.p.k si më poshtë:

- Me-kompanine “E...-S...- T...-C... SHPK”1- janë kryer shitje në vlerën mineraleve në vlerën totale **43.740.000** leke ,e vertetuar kjo nga faturat e shitjes me

numer serial 40850631 te dates 13.06.2013 si dhe fatures tatimore te shitjes me turner serial 40850633 te dates 27.08.2013.

- Me kompanine “E... T...E... T... M... GROUP” jane kryer shitje te mineraleve ne vleren totale **41.227.290 leke** e vertetuar kjo nga faturat tatimore te shitjes me numer serial nr 40850630 te dates 06.06.2013 me vlerë si dhe fatures tjeter tatimore te shitjes me numer serial 40850632 te dates 01.08.2013.

Shoqëritë e padituara, me përfaqësues ligjor shtetasin nën hetim S. N., në Gjykatë nuk i kanë pranuar këto fatura duke deklaruar se malli I faturuar sipas kater faturave të sipercituara nuk është marrë në dorëzim nga këto shoqëri dhe kjo është arsyeja pse ato nuk e kanë paguar çmimin e deklaruar në këto fatura. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata e Rrethi Gjyqësor Tiranë, me vendimin 6033, dt16.07.2015(vendim I lënë në fuqi nga gjykata e apelit) ka rrëzuar pretendimin e paditësit duke arsyetuar se malli nuk është dorëzuar.

Ky vendim I gjykatës është në unison me provat e administruara gjatë hetimit të kësaj çështje penale nga e cila rezulton se faturat e subjektit “E... 06” sh.p.k janë fictive.

Kështu nga kqyrja e faturave tatimore të shitjes të lëshuara nga subjekti “E... 06” për dy subjektet në pronësi të shtetasit S. N., rezulton se sipas secilës prej faturave janë shitur sasi shumë të mëdha minerali me një faturë të vetme, ku nga një përlllogaritje paraprake dhe e përfaërt e kapacitet të mjeteve të shënuara në faturë, do të duheshin të bëheshin 150 rrugë për transportin e mineralit(sipas legjislacionit tatimor për çdo transport të kryer lëshohet një faturë tatimore). Pra nuk kemi të dokumentuar mënyrën e transportit nga shoqëria shitëse te shoqëritë blerëse, fakt ky që po ashtu na bën të dyshojmë se këto fatura janë fictive.

Nga të dhënat e administruara nga AKBN ka rezultuar se subjekti E... 06 sh.p.k ka marr një leje shfrytëzimi Nr.... datë 20.05.2009 nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës(e cila tashmë e revokuar për shkleje të kryera nga subjekti). Nga krahasimi I sasise se prodhuar dhe blerë nga subjekti E... 06 me sasinë e kromit që ky subjket ka shitur rezultojnë mospërputhje sipas të dhënave të deklaruara. Kjo mospërputhje behet akoma edhe më e madhe pot ë kihet parasysh disa të dhëna të tjera të administruara gjatë procedimit penal.

Në llogarinë personale bankare të shtetasit M. D.(admistrator dhe ortak i E... 06) është kredituar shuma 9.364.908 lekë me përshkrimin transfertë për shitje kuotash tek shoqëria “Euro Chrome” sh.p.k me Nipt L21703027G dhe përfitues ish ortakët R. D. dhe Mehmet Dauti. Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në ekstraktin tregtar të subjektit në QKR nuk rezulton të ketë ndryshime. I pyetur në lidhje me këtë fakt i pandehuri M. D.ka deklaruar se I ka shitur kësaj shoqërie krom pa fature në këmbim të vlerës së kredituar në llogaritë personale të tij.

Gjithashtu nga kqyrja e të gjitha faturave të shitjes së subjektit “E... 06” sh.pk vihet re një numer I madhe I faturave të anulura, fatura të cilat janë të plotësuar dhe të nënshkuara edhe nga shitësi edhe nga blerësi(faturat janë të shkëputura nga blloku). Këto fatura të anuluarat mendohet të kenë shërbyer për të transportuar chrom të prodhuar në mënyrë informale nga vend burimet e chromit, nga subjekte të ndryshme tregtare(me qëllim që të mos kishte problem gjatë transportimit nga kontrollet e ndryshme të organeve ligjzbatuese).

Kryerja e pagesave pjesore për këto fatura, pikërisht në momentin kur duhet të eksportohej malli nga shoqëritë e administruara nga shtetas inën hetim S. N., është një e dhënë tjetër që tregon fiktivitetin e fatuarve të sipërcituara.

Këto fatura fictive të analizuara si më sipër, të pranuar si të tilla(pra si fictive) nga i pandehuri S. N., janë deklaruar në dogane si fatura justifikuese për eksportet e kryera nga shoqëritë” E... T... C...” dhe “ E... T...E... T... M... E... T...”. Ato janë deklaruar në librat e blerjes së këtyre shoqërive, është kredituar TVSh-ja në vlerën 20.526,813 lek per tre nga të cilat është kërkuar edhe rimbursim pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, rimbursim I cili është marrë.

Nga dokumentacioni I marrë nga doganat rezulton se për periudhën Mars-Gusht të vitit 2013 shoqëria:

1. “Euro Speed Trans Chrom” me Nipt K21423002T, ka kryera 2 procedura eksporti me deklaratat doganore R-61342 datë 31.08.2013 dhe R-61344 datë 31.08.2013. Nga studimi i këtij materiali rezulton se në praktikën doganore është përfshirë edhe fatura e e shitjes e subjektit “E... 06” e datës 13.06.2013, për të cilën shtetasi S. N., me cilësinë e administratorit të shoqërisë “Euro Speed Trans Chrom”, ka deklaruar në gjykatë se nuk e ka marrë mallin.
2. Ndërsa shoqëria „E... T...E... T... M... group“ ka kryer gjatë vitit 2013 6 praktika doganore eksporti, në dokumentacionin e të cilave ndodhen fatura të shoqërisë E... 06”Nga informacioni I marrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore tatimpaguesve të mëdhenj me shkresën me nr.16772/1 prot të dates 12.12.2016 rezulton se të gjashta faturat e lëshuara nga shoqëria “E... 06” sh.p.k janë deklaruar nga shoqëritë” E... T... C...” dhe “ E... T...E... T... M...E... T...” janë deklaruar si fatura blerje, është kredituar TVSH 20.526,813 dhe përveç sa më sipër subjekti “E... T... M... Group”, vlerën e kredituar të TVSH-së, që ka rrrjedhur nga këto fatura edhe e ka rimbursuar, vlerë e paguar nga Drejtoria Rajonale e Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj në llogaritë e kësaj shoqërie.

Lëshimi i faturave fiktive në shitje nga subjekti “E... 06”, për shoqëritë e administruara nga I pandehuri S. N., krijonte **tvsh** kreditore që duhet të paguhej për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, pra për llogari të buxhetit të shtetit. Për shmangien e kësaj pagese në të njëjtat periudha tatimore në të cilat janë deklaruar faturat fiktive në shitje

nga shoqëria “E... 06, janë siguruar dhe deklaruar fatura fiktive në blerje me qëllim shmangien e pagesës së TVSH-së, që siç u theksua më sipër krijohet nga deklarimi i faturave fiktive në shitje.

Gjatë hetimit të çështjes janë administruar të dhëna të plota nga të cilat vërtetohet se faturat e deklaruara në blerje nga subjekti “E... 06” sh.p.k janë të falsifikuara. Në total janë 201 fatura të lëshuara nga 25 subjekte të ndryshme të ndryshme tregtare të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytete të ndryshme të Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së këtyre 25 shoqërive është kryesisht : “Import- eksport, investees, tregti prodhues”. Këto subjekte prodhuese ose importese duke qënë se shesin mallra pa faturë në subjekte të ndryshme të cilat veprojnë në treg në mënyrë informale, u krijohet mospërputhje midis gjëndjes fizike dhe gjëndjes kontabël dhe për rregullimin e situatës lëshojnë fatura fiktive me qëllim përputhjen e gjëndjes fizike dhe kontabël, duke kryer këtë proces që në gjuhën e përditshme konsiderohet “ shkarkimi i mallit apo tvsh-së”, ashtu siç vetë disa subjekte kanë deklaruar. Nga ana tjetër këto fatura fiktive shërbejnë për uljen e gjëndjes kreditore të subjekteve blerës, si në rastin konkret subjekti “E... 06” sh.p.k duke shmangur në këtë mënyrë pagesën e TVSH-së, tatimit të fitimit, tatimit mbi dividentin etj.

Nga te gjitha sa me lart kane rezultuar,organi procedues pas veprimeve hetimore deri ne ket faze te hetimit dhe procedimit penal,ka konkluduar se pandehuri S. N.,ka siguruar në mënyrë paligjshme kromim, pa respektuar rregullat që përcakton ligji minerar dhe legjislacioni tatimor. Për të bërë të mundur eksportimin e këtij malli, nga shoqëritë e administruara prej tij, ai ka siguruar fatura fictive nga shoqëria “E... 06” sh.p.k, pa te cilat malli nuk mund të eksportohej. Gjithashtu faturat fiktive janë deklaruar pranë tatimeve duke kredituar padrejtësisht TVSH-në e këtyre faturave dhe rimbursimin e tyre.

Lëshimi I faturave fictive në shitje nga subjekti “E... 06”, krijonte Tvsh debitore (që duhet të paguhej), per cdo muaj(per cdo periudhe tatimore) dhe nga ana tjetër ajo ishte një ardhur për shoqërinë për të cilën në fund të vitit duhej të paguhej tatimi i fitimit dhe më tej tatimi mbi dividentin. Për shmangien e detyrimeve tatimore, nga ana e shoqërisë “E... 06” për të njëjtat periudha tatimore në të cilat janë deklaruar faturat fictive në shitje janë siguruar dhe deklaruar fatura fictive në blerje. Pas konstatimeve të kryera nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë janë nxjerrë detyrimet tatimore për këto shoqëri “E... 06” sh.p.k si dhe janë marrë masat administrative për vjeljen me forcë të detyrimit tatimor por detyrimi ka ngelur i pambledhur(pa paguar) për shkak se shoqëria nuk ka një aktivitet real.

Në përfundim të analizës faktike dhe ligjore të sipërcituar organi procedues,referuar fakteve dhe rrethave ka arritur ne konkluzionin se : i pandehuri S. N.ka konsumuar elementët e veprave penale të “Falsifikimit të formularëve” të kryer nga personi që ka për detyrë lëshimin e dokumentit dhe në bashkepunim me shtetasin nën hetim M. D., ”Krijimin e

skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar” , ”Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 190/3 e 25 , 144/a dhe 287 të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, ne baze te nenit 259 te K.Pr.Penale, me vendimin e dates 17.11.2016, ka vendosur:

1. **Pranimin e kerkeses se Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane per caktimin e mases se sigurimit shtetasit S. N..**
1. **Vendosjen e mases se sigurimit “Arrest ne burg” per shtetasin S. N., i biri i B. dhe S., me dtl.04.09.19.. si i dyshuar per kryerjen e vepres penale te parashikuar nga neni 144/a dhe 186 i K.Penal.**

Kunder ketij vendimi I shtetasi I dyshuar S. N., ka paraqitur ankim dhe nga gjykata me e lart eshte vendosur ndryshimi I mases se sigurimit me nje mase tjeter me te bute si ajo e “arrestit ne shtepi”.

Me kerkesen e drejtuar kesaj gjykate, organi procedures I ka kerkuar gjykates sipas objektit te gjykimit me siper cituar (ne pjesen hyrese te vendimit).

Keshtu sipas organit procedues ka rezultuar se në vitin 2015 i pandehuri S. N. ka blerë 9 pasuri të paluajtshme (apartamente garazhe) tek shoqëria R... B...” shpk me NIPT K8...1VK8...1V. Blerja e këtyre pasurive rridhte nga kontrata sipërmarrje të lidhura në vitin 2013 ndërmjet shtetasit S. N./ose shoqërisë “E... T...E... T... M... Group” me shoqërinë R... B...” shpk me NIPT K8...1VK8...1V. Pagesat e këtyre kontratave janë bërë nga shoqëria “E... t... m... Group” në vitin 2014.

Më datë 21.07.2014 janë paguar në llogaritë e shoqërisë R... B...” shpk nga shoqëria “E... T...E... T... M... Group” 1,934, 940 Euro, me pershkrim parapagim për blerje asetesh kontrate sipas kontratave të sipërmarrjes të cilat ndodhen në secilën praktikë pasurie. Këto pasuri përshkruhen si më poshtë me vlerë totale **2,375,525 Euro** :

Pasuri e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 222, per numrin e pasurise .../...+...-..., ne emer të Xh. S. N.e përfutuar sipas kontratës së dhurimit me Kusht me nr.... Rep, Nr.... Kol, date 03.04.2017, flete 4. Kjo pasuri ka rrjedhur nga kontrata e shitjes Pasurie te Paluajtshme, nr.... Rep, nr.... Kol, date 30.03.2015 lidhur ndërmjet shoqërisë R... B...” shpk me NIPT K8...1V dhe shtetasit S. N.. Vlera e pasurisë 362.115 Euro.

Pasuria e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 206, per numrin e pasurise .../...+...-..., përfutuar sipas kontratës së dhurimit me nr.... Rep, Nr.... Kol, date 06.04.2017, ne emer të shtetasit L. N.... Kjo pasuri ka rrjedhur nga kontrata e shitjes Pasurie te Paluajtshme, nr.... Rep, nr.... Kol, date 23.12.2015 lidhur ndërmjet shoqërisë R... B...” shpk me NIPT K8...1V dhe shtetasit S. N.. Vlera e pasurisë 362,715 Euro.

Pasuri e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 230, per numrin e pasurise ...+...-..., në emer të f. N. e përfituar nga kontrata e dhurimit me Kusht me nr.... Rep, Nr.... Kol, date 03.04.2017. Kjo pasuri ka rrjedhur nga kontrata e shitjes Pasurie te Paluajtshme, nr.... Rep, nr.... Kol, date 30.03.2015 lidhur ndërmjet shoqërisë R... B...” shpk me NIPT K8...1V dhe shtetasit S. N.. Vlera e pasurisë 361,455 Euro.

Pasuri e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 213, per numrin e pasurise ...+...-..., Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, nr.... Rep, nr.... Kol, date 30.03.2015, në emer të _____ me vlere 140, 840 Euro;

Pasuri e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 139, per numrin e pasurise ...+...-..., ne eemer të E... T..., e cila rrjedh Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, nr.... Rep, nr.... Kol, date 30.03.2015, flete 4(kater). në vlerën 142.455 EUR;

Pasuria Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 135, per numrin e pasurise ...+...-..., ne emer të E... T... e cila rrjedh Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, nr.... Rep, nr.... Kol, date 30.03.2015, në vlerën 361,455 Euro ;

Pasuria e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 133, per numrin e pasurise ...+...-..., ne emer të E... T... e cila rrjedh Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, nr.... Rep, nr.... Kol, date 30.03.2015, në vlerën 218.145 Euro.

Pasuria se Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 136, per numrin e pasurise ...+...-..., e cila rrjedh nga Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, nr.... Rep, nr.... Kol, date 30.03.2015, në vlerën 207.000 Euro;

Pasuria e Pasurise se Paluajtshme me Nr.Reference, zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 134, per numrin e pasurise ...+...-..., e cila rrjedh nga Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, nr.... Rep, nr.... Kol, date 30.03.2015, vlera 219 345 Euro

Kontratat e shitjes janë bazuar në një kontratë të mëparshme sipërmarrje të lidhur ndërmjet shoqërisë “R... B...” shpk me NIPT K8...1V dhe shtetasit S. N.apo shoqërisë “E... m... group”.

Duke qenë se këto shuma parash, dyshohet se burojnë nga transaksione të dyshimta, si dhe duke qenë se dyshohet se poseduesit e këtyre llogarive, kanë mundësi të veprojnë me këto llogari apo depozita për vazhdimin e transaksioneve të tilla, organi procedues i ehste drejtuar gjykates ,pikerisht per marrjen e mases se sekuestros preventive ndaj tyre,referuar ne nenet 274 te K.Pr.Penale dhe 36 te K.Penal.

Ne lidhje me kerkesen gjykata iu referua:

Nenet 274 te K.Pr.Penale,i cili parashikon se : « Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata

kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të K.Penal ».

Nenit 36 të Kodit Penal ku parashikohet se:

“Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:

- a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale;
- b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;
- c) të shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale;
- ç) të çdo pasurie tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale;
- d) të sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbëjnë veprë penale, edhe

kur nuk është dhënë vendim dënimi.

2. Nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shndërruar pjesërisht ose plotësisht në pasuri të tjera, këto të fundit i nënshtrohen konfiskimit.

3. Nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale.

4. Konfiskimit i nënshtrohen edhe të ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës

penale, nga pasuritë në të cilat janë transformuar ose shndërruar produktet e veprës penale ose nga pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse produktet e veprës penale.

Në ratsin konkret, dyshohet se i pandehuri S. N. nëpërmjet dokumentave të falsifikuar produkteve të veprës penale të sipërcituara, ka mbuluar natyrën e vërtetë të tyre të kundraligjshme dhe i ka paraqitur si të produkte të ardhura nga një veprimtari i ligjshme minerare dhe më pas e ka shitur produktin e kundraligjshëm ka siguruar të ardhura të cilat i ka investuar në veprimtari ekonomike dhe financiare duke konsumuar veprën penale të pastrimit të parave, sipas pikave b dhe d) të Kodit Penal.

Nga akti i ekspertimi kontabël ka rezultuar se Vlera totale e sasisë së Chromit që shoqëria “E... 06” sh.p.k., me nipt K7...8Q, ka shitur për shoqëritë “E...-S...-T...-C...” sh.p.k me NIPT K2...2T dhe “E... T... M... Group” me NIPT K9...7I, është 27,000

ton me çmim mesatar 138.87 dollar dhe ne vlere 3,749,490dollar konvetuar me kursin (1\$=101.86 leke) të dates 31.12.2013 sipas Bankes se Shqiperise, vlere ne lekë per gjithë sasinë e kromit të shitur është 381,923,051 leke, e shprehur në monedhën euro 2,724, 130 Euro. Gjithashtu vlere e TVsh-së të kredituar padrejtësisht nga shoqëritë e admnistruara nga I pandehuri S. N.është 20.526,813 leke

Nga hetimet e kryera ,te cilat iu vune ne dispozicion gjykates per shqyrtimin e kerkeses, kanë rezultuar se në vitin 2015 i pandehuri S. N.ka blerë 9 pasuri të paluajtshme(apartamente garazhe) tek shoqëria R... B...” shpk me NIPT K8...1V. Blerja e këtyre pasurive rridhte nga kontrata sipërmarrje të lidhura në vitin 2013 ndërmjet shtetasit S. N./ose shoqërisë “E... T...E... T... M... Group” me shoqërinë R... B...” shpk me NIPT K8...1V. Pagesat e këtyre kontratave janë bërë nga shoqëria “E... T... M... Group” në vitin 2014.

Kështu më datë 21.07.2014 janë paguar në llogaritë e shoqërisë R... B...” shpk nga shoqëria “E... T...E... T... M... Group” 1,934, 940 Euro, me pershkrim parapagim për blerje asete kontrate sipas kontrateve të sipërmarrjes të cilat ndodhen në secilën praktikë pasurie. Këto pasuri përshkruhen si më poshtë me vlerë totatle **2,375,525Euro** :

Pasuri e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 222, per numrin e pasurise ...+...-..., ne emer të Xh. S. N.e përfituar sipas kontratën së dhurimit me Kusht me nr.... Rep, Nr.... Kol, date 03.04.2017, flete 4. Kjo pasuri ka rrjedhur nga kontrata e shitjes Pasurie te Paluajtshme, nr.... Rep, nr.... Kol, date 30.03.2015 lidhur ndërmjet shoqërisë R... B...” shpk me NIPT K8...1V dhe shtetasit S. N.. Vlere e pasurisë 362.115 Euro.

Pasuria e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 206, per numrin e pasurise ...+...-..., përfituar sipas kontratës së dhurimit me nr.... Rep, Nr.... Kol, date 06.04.2017, ne emer të shtetases L. N.. Kjo pasuri ka rrjedhur nga kontrata e shitjes Pasurie te Paluajtshme, nr.... Rep, nr.... Kol, date 23.12.2015 lidhur ndërmjet shoqërisë R... B...” shpk me NIPT K8...1V dhe shtetasit S. N.. Vlere e pasurisë 362,715 Euro.

Pasuri e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 230, per numrin e pasurise ...+...-..., në emer të f. N. e përfituar nga kontrata e dhurimit me Kusht me nr. ... Rep, Nr. ... Kol, date 03.04.2017. Kjo pasuri ka rrjedhur nga kontrata e shitjes Pasurie te Paluajtshme, nr. ... Rep, nr. ...Kol, date 30.03.2015 lidhur ndërmjet shoqërisë R... B...” shpk me NIPT K8...1V dhe shtetasit S. N.. Vlere e pasurisë 361,455 Euro.

Pasuri e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 213, per numrin e pasurise ...+...-..., Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, nr. ... Rep, nr. ...Kol, date 30.03.2015, në emer të _____ me vlere 140, 840 Euro;

Pasuri e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 139, per numrin e pasurise ...+...-..., ne eemer të E... T..., e cila rrjedh Kontrate Shitje Pasurie

te Paluajtshme, nr. ... Rep, nr. ...Kol, date 30.03.2015, flete 4(kater). në vlerën 142.455 EUR;

Pasuria Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 135, per numrin e pasurise ...+...-..., ne emer të E... T... e cila rrjedh Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, nr. ... Rep, nr. ...Kol, date 30.03.2015, në vlerën 361,455 Euro ;

Pasuria e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 133, per numrin e pasurise ...+...-..., ne emer të E... T... e cila rrjedh Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, nr. ... Rep, nr. ...Kol, date 30.03.2015, në vlerën 218.145 Euro.

Pasuria se Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 136, per numrin e pasurise ...+...-..., e cila rrjedh nga Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, nr. ... Rep, nr. ...Kol, date 30.03.2015, në vlerën 207.000 Euro;

Pasuria e Pasurise se Paluajtshme me Nr.Reference 14563, zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 134, per numrin e pasurise ...+...-..., e cila rrjedh nga Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, nr. ... Rep, nr. ...Kol, date 30.03.2015, vlera 219 345 Euro

Kontratat e shitjes janë bazuar në një kontratë të mëparshme sipërmarje të lidhur ndërmjet shoqërisë “R... B...” shpk me NIPT K8...1V dhe shtetasit S. N.apo shoqërisë “E... m... group”.

Duke qenë se këto shuma parash, dyshohet se burojnë nga transaksione të dyshimta, si dhe duke qenë se dyshohet se poseduesit e këtyre llogarive, kanë mundësi të veprojnë me këto llogari apo depozita për vazhdimin e transaksioneve të tilla, gjykata cmon se kërkesa e organit procedues per marrjen e mases se sigurimit pasuror dhe vendosjen e sekuestros preventive ndaj tyre,eshte e bazuar,konkretisht ne nenet 274 te K.Pr.Penale dhe 36 te K.Penal.

Kjo masë sigurimi pasuror meret nga gjykata me synim ruajtjen e këtyre pasurive të cilat kanë rrjedhur nga vepra penale, ne gjendjen që janë, duke parandaluar në këtë mënyrë, transferimin e tyre dhe tjetërsimin apo fshehjen, duke shmangur në këtë mënyrë shtimin e pasojave të kësaj vepre penale.

P. K. A

Gjykata në bazë të nenit 210,274 të K.Pr.Penale

V E N D O S I

-Pranimin e kërkeses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me procedimin penal Nr.9749/2014 .

-Vendosjen e mases se sigurimit sekuestro prevenetive per pasurite e poshteshenuara:

-Pasuri e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 213, per numrin e pasurise ...+...-..., **ne pronesi te te pandehurit S. N., e cila eshte**

blere sipas Kontrates Shitje Pasurie te Paluajtshme, ..., ne emer te me vlere 140, 840 Euro;

-Pasuri e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 139, per numrin e pasurise ...+...-...ne pronesi te **te pandehurit E... T... M... Group**, e cila rrjedh Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, ..., flete 4(kater) ne vleren 142.455 Euro;

-Pasuria Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 135, per numrin e pasurise ...+...-..., ne pronesi te **te pandehurit E... T... M... Group** e cila rrjedh Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, ..., ne vleren 361,455 Euro;

-Pasuria e Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 133, per numrin e pasurise ...+...-..., ne pronesi te **te pandehurit E... T... M... Group** e cila rrjedh Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, ..., ne vleren 218.145 Euro;

-Pasuria se Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 136, per numrin e pasurise ...+...-..., ne pronesi te **te pandehurit te E... T... M... Group** e cila rrjedh nga Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, ..., ne vleren 207.000 Euro;

-Pasuria e Pasurise se Paluajtshme , ne pronesi te **te pandehurit te E... T... M... Group** me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 134, per numrin e pasurise ...+...-..., e cila rrjedh nga Kontrate Shitje Pasurie te Paluajtshme, ..., vlera 219 345 Euro;

-Pasurise se Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 222, per numrin e pasurise ...+...-..., ne pronesi te **Xh. S. N.**e perfituar sipas kontraten se dhurimit me Kusht ..., flete Kjo pasuri ka rrjedhur nga kontrata e shitjes Pasurie te Paluajtshme, ... lidhur ndermjet shoqerise R... B..." shpk me NIPT K8...1V dhe shtetasit S. N.. Vlera e pasurise 362.115 Euro.

-Pasuria e palujtshme me nr.reference ... ,ZK 8160 ,vol42 ,fq.206,per numrin e pasurise ...+...-...,perfituar sipas kontrates se dhurimit me ..., ne pronesi te **L. N...(bashkeshortja e S.)**. Kjo pasuri ka rrjedhur nga kontrata e shitjes Pasurie te Paluajtshme, ... lidhur nderrnjet shoqerise R... B..." shpk me NIPT K8...1V dhe shtetasit S. N.. Vlera e pasurise 362,715 Euro.

-Pasurise se Paluajtshme me Nr.Reference ..., zona kadastrale nr.8160, volum 42, faqe 230, per numrin e pasurise ...+...-..., ne pronesi te **F. S. N.**e perfituar nga kontrata e dhurimit me Kusht Kjo pasuri ka rrjedhur nga kontrata e shitjes Pasurie te Paluajtshme, ... lidhur ndermjet shoqerise R... B..." shpk me NIPT K8...1V dhe shtetasit S. N.. Vlera e pasurise

GjykataTirane_SekPrev_2017_Vend806_ProcPen9749

-Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tirane, brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë.

U shpall sot ne Tirane me dt. 03.05.2017.

SEKRETARE
BLERINA ORUÇI

GJYQTARE
FATIME DEÇOLLI